URDHËR
Nr. 413/1, datë 27.9.2021

PËR NJË NDRYSHIM NË URDHRIN NR. 413, DATË 24.9.2021, "PËR MARRJEN E MASAVE, PËR PARANDALIMIN E INFEKSIONIT COVID-19, PËR PERSONELIN E INSTITUCIONEVE ARSIMORE DHE STUDENTËT"

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 7, të nenit 18, të ligjit nr. 15/2016, "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", të ndryshuar; të udhëzimeve të Institutit të Shëndetit Publik, të Komitetit të Ekspertëve të Imunizimit të datës 29.8.2021, si edhe në zbatim të vendimit të Komitetit të Përkohshëm për Infeksionin e Përhapur nga Coronavirus i ri nr. 3614 prot., datë 30.8.2021, me qëllim mbrojtjen e shëndetit të popullatës nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19,

URDHËROJ:

Në urdhrin nr. 413, datë 24.9.2021, "Për marrjen e masave, për parandalimin e infeksionit COVID-19, për personelin e institucioneve arsimore dhe studentët", bëhet një ndryshim si më poshtë vijon:

1. Pika 4 riformulohet si më poshtë vijon:

"4. Studentët duhet të paraqesin certifikatën e vaksinimit COVID-19 apo kartën e vaksinimit, për të hyrë në institucionet e arsimit të lartë, duke filluar nga data 11.10.2021.".

2. Ky urdhër i përcillet ministrisë përgjegjëse për arsimin.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
Ogerta Manastirliu